



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE**

LËNDA:

**GJUHA FRËNGE
(Gjuha e huaj e parë)**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

VITI MËSIMOR 2011 – 2012

1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHTETËRORE PËR LËNDËN E FRËNGJISHTES DHE PËR PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Programi orientues i provimit kombëtar të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge përmban në mënyrë të përmbledhur sasinë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë në tre vitet e gjimnazit në aspektin tematik dhe në aspektin gjuhësor e funksional. Mësimi i gjuhës frënge ndihmon në mënyrë të veçantë formimin e përgjithshëm të nxënësit, duke mundësuar pajisjen e tij me një mjet shprehës më tepër, me teknikat dhe metodologjinë e përshtatshme komunikative që do t'i shërbejnë për t'u bërë pjesë e shkëmbimeve të shumëllojshme në situata të larmishme jetësore, si dhe me një mjet më shumë për të njohur botën dhe për të pasuruar dijet.

Për hartimin e këtij programi orientues u morën parasysh korniza kurrikulare e gjuhëve të huaja, standardet e gjuhës së huaj në arsimin parauniversitar, programet e tre viteve të gjimnazit, si edhe tekstet me të cilat zhvillohet mësimi i gjuhës frënge në gjimnaz.

Synimet e programit

Me anë të këtij programi orientues synohet:

- Të ndihmohen nxënësit maturantë në përgatitjen e provimit të gjuhës frënge, si edhe mësuesit për të dhënë orientimet e duhura në punën përgatitore me nxënësit.
- Të bëhet vlerësimi i njëkohshëm i dy aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj), që përbëjnë dhe **dy konceptet bazë**, që janë:
 - 1) **të lexuarit dhe të kuptuarit dhe**
 - 2) **të shprehurit me shkrim.**
- Të jepen orientime për hartuesit e testeve të provimit kombëtar të maturës shtetërore për gjuhën frënge.
- të vlerësohet të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, në aspektin e tyre morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional.
- të aftësohen nxënësit maturantë për të përdorur njohuritë gjuhësore në mënyrë të pavarur, korrekte dhe në përputhje me situatat e larmishme të komunikimit.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Mësuesit dhe nxënësit që do të përdorin këtë program, të kenë parasysh faktin që në provim nxënësit do të përballen me një tekst krejt të ri mbi të cilin do të punohet, por tematika, strukturat gramatikore, si edhe aktet e komunikimit do të jenë po ato që janë studiuar gjatë tre viteve.

Mësuesi të kujdeset që nxënësit të përvetësojnë një sasi të gjerë e të konsiderueshme njohurish leksikore, që ngërthejnë në mënyrë përgjithësuese temat e përfshira në program. Kur flitet për tematikën (p.sh., l'environment et les paysages), nuk do të thotë që në provim do të punohet i njëjti tekst që ndodhet në njërin nga librat e tre viteve. Do të

zgjidhet një tekst i ri me të njëjtën tematikë, për të cilën nxënësi duhet të jetë në gjendje të përgjigjet.

E njëjta praktikë të ndiqet edhe për dukuritë gramatikore. Mësuesi t'i përgatisë nxënësit që të jenë të aftë të zgjidhin ushtrime gramatikore në një kontekst të ri dhe në situata të ndryshme nga ato që janë paraqitur në librat e tre viteve, duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale, që jepen nëpër tekste, dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh ku të përfshihen këto aspekte gramatikore, duke e parapërgatitur nxënësin për ato që do të trajtohen në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Mësuesi të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve.

Aktet e komunikimit dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që janë studiuar gjatë tre viteve, por të përdorura në mënyrë përgjithësuese në situata të larmishme nga të gjitha fushat e jetës.

Mësuesi duhet të përgatisë dhe aftësojë nxënësit në të shprehurit me shkrim, me qëllim që ata të lidhin fjalët në fjali, fjalitë në paragrafë dhe paragrafët në ese me një lidhje koherente; të përmbledhin me shkrim një përvojë personale, duke shprehur ndjenjat dhe reagimet e tyre në një tekst koherent dhe të argumentuar.

2. AFTËSITË DHE NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS NË GJUHËN FRËNGE (LËNDË BËRTHAMË)

Në provimin e Maturës Shtetërore, nxënësit do të vlerësohen për dy aftësitë gjuhësore:

2.1 Të kuptuarit me shkrim (leximi dhe kuptimi i një dokumenti të shkruar)

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen ushtrime kuptimore.

Nxënësi të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë globale tekste të gjata për të gjetur informacionin e dëshiruar; për të mbledhur informacione nga pjesë të ndryshme të një teksti apo nga tekste të ndryshme, për të përmbushur një detyrë të caktuar. Nxënësi duhet të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave, të zbulojë përfundimet kryesore të një teksti argumentues, të zbulojë skemën argumentuese të ndjekur për parashtrimin e një problemi, të zbulojë thelbin e një artikulli gazete të thjeshtë e të shkruar qartë, të kuptojë udhëzime, fletëpalosje, formularë, biografi etj.

Në një pjesë leximi, nxënësi të dallojë faktin nga opinioni, duke përdorur informacion të saktë, argumente dhe pikëpamje që të jenë koherente.

Është e rëndësishme që ai të dallojë informacionin thelbësor nga ai i parëndësishëm, duke vendosur kritere për gjykim, analizë dhe nxjerrje konkluzionesh rreth një çështjeje të caktuar.

Për të kryer këtë detyrë, nxënësi duhet të aftësohet që të kapë:

- Kuptimin global të tekstit.
- Kuptimin përzgjedhës: gjetjen e informacioneve apo të dhënave specifike që kërkohen.
- Kuptimin e thelluar të tekstit: zbulimin e të pashprehurës, asaj që nënkuptohet apo qëndrimin e autorit.
- Përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Zgjidhjen e ushtrimeve leksikore dhe gramatikore rreth tekstit.
- Formimin e një kuptimi të përgjithshëm.
- Marrjen dhe përzgjedhjen e informacionit të duhur brenda një teksti të caktuar.
- Reflektimin mbi përmbajtjen e një teksti dhe vlerësimin se sa me vend janë disa elemente të informacionit.
- Zhvillimin e aftësisë interpretuese, duke nxjerrë një përfundim logjik.
- Gjetjen e një informacioni sinonim.
- Zhvillimin e aftësisë interpretuese, duke bërë identifikimin dhe paraqitjen e elementeve provuese.
- Reflektimin mbi përmbajtjen e një teksti duke u bazuar mbi disa vlera dhe bindje për të dhënë një gjykim në lidhje me moralin e një historie.

2.2 Të shprehurit me shkrim

Në provimin e Maturës, nxënësi të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë të gjerë temash, duke i lidhur elementet në mënyrë lineare: të bëjë përshkrime të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real apo imagjinar, tregon një histori, të shkruajë një ese argumentuese për tema me interes të përgjithshëm, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, të shkruajë komentin e një filmi shkurt e qartë, të shkruajë një informacion duke u nisur nga shënimet e marra etj.

Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej 150-200 fjalësh, në të cilin të zhvillojë një temë mbi një çështje me interes të përgjithshëm, duke marrë shkas nga pjesa e panjohur ose që nuk ka lidhje me të:

- të shprehurit me shkrim do të mbulojë një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse për të cilat është folur gjatë mësimeve në tre vitet;
- nxënësi paraqet një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar
- mirë (letër zyrtare apo personale, paragrafë të lidhur në mënyrë logjike);
- nxënësi lidh në mënyrë logjike informacione nga burime të ndryshme;

- nxënësi shpreh pikëpamjet e tij në formë të argumentuar;
- nxënësi përdor një repertor të gjerë leksikor;
- nxënësi bën komente me shkrim për probleme të ndryshme që i kërkohen;
- të dijë të organizojë mirë përmbajtjen e punës me shkrim duke qenë gjithnjë në
- koherencë me temën e dhënë;
- të vendosë dhe të ruajë një këndvështrim të vetin dhe origjinal për temën mbi të cilën do shkruajë;
- të shkruajë paragrafë të plotë në të cilët të ketë detaje dhe informacione specifike për temën e dhënë;
- të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar;
- të përdorë tipe dhe gjatësi të ndryshme fjalish.

Njohuritë

Njohuritë kryesore leksikore që nxënësi ka marrë gjatë tre viteve të gjimnazit, janë paraqitur përmes përmbajtjes tematike të këtij programi, e cila zhvillohet më poshtë e ndarë në fusha dhe nënfusha sipas tematikës së zhvilluar në gjimnaz. Në program paraqiten edhe elementet gramatikore të përmbledhur në materialin morfosintaksor, që është zhvilluar e përvetësuar gradualisht e në mënyrë spirale gjatë tre viteve të gjimnazit.

Shprehitë

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të gjimnazit janë dhënë përmes akteve dhe funksioneve komunikative që përmban programi i gjimnazit, përmes të cilit nxënësi aftësohet t'i ripërdorë në situata të reja e të larmishme komunikimi.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për çdo fushë

Të kuptuarit me shkrim (Compréhension écrite)
<ul style="list-style-type: none"> - pyetje mbi përmbajtjen e tekstit, - ushtrime me plotësim të vendeve bosh, - ushtrime me disa zgjedhje, - renditja e paragrafëve të ngatërruar, sipas logjikës dhe rrjedhës logjike, - gjetja e një informacioni në një tekst, - gjetja e idesë kryesore të një teksti, - gjetja e një informacioni nga tekste të ndryshme etj.

Leksiku dhe gramatika (Lexique et grammaire)	
<ul style="list-style-type: none"> - ushtrime me zëvendësim, - ushtrime transformimi, - ushtrime me shumë zgjedhje, - ushtrime me plotësime vendesh bosh, - ushtrime me ndërtim fjalish, - bashkim fjalësh me kuptim, gjetje gabimesh, bashkim i funksionit me strukturën përkatëse, - gjetja e sinonimeve, antonimeve, - shprehja e të njëjtit kuptim me fjalë të tjera, parafrazime etj. 	
- Të shkruarit (l'expression écrite)	
<ul style="list-style-type: none"> - formulim pyetje / përgjigje, - plotësim frazash, - letër personale, - letër zyrtare, - mesazh, - radhitje paragrafësh sipas rrjedhës logjike, - hartim me pika referimi, - përmbledhje, koment, - tregim, koment etj. 	

Ndarja e peshës sipas fushave

FUSHAT	Përqindja
Të kuptuarit me shkrim	30 %
Leksiku dhe gramatika	40 %
Të shprehurit me shkrim	30 %

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fushat tematike dhe leksiku

Kjo rubrikë e programit grupon linjat kryesore, si edhe nënlinjat, të cilat janë të zhvilluara në programin e gjimnazit. Ato reflektojnë ngushtësisht interesat e motivimin e nxënësve dhe rrokin gjithë sferën e marrëdhënieve *familje-shoqëri-nxënës*, sferën publike dhe sferën profesionale, si dhe aspektin kulturor e qytetërimin.

Përmbajtja tematike e programit është mbështetur në programin e zhvilluar gjatë tre viteve të gjimnazit, por edhe në tekstet shkollore për gjuhën frënge. Tematika e parashikuar për provimin e Maturës përfshin temat bazë sipas kurrikulës dhe programeve, si edhe nëntemat që gjenden në tekstet e gjuhës frënge që përdoren në gjimnaz.

Kujdes!

Duke pasur parasysh se shkollat e zhvillojnë mësimin me libra të ndryshëm, tematika është formuluar në mënyrë përgjithësuese dhe jo sipas titujve të mësimëve me të cilët nxënësit janë familjarizuar, por sigurisht përfshin të gjitha njohuritë e përvetësuara gjatë tre viteve përmes këtyre teksteve:

LE MONDE DU TRAVAIL

- mes projets d'avenir
- les professions.

L'ÉCOLE ET L'ÉDUCATION

- les relations entre les professeurs et les étudiants
- les activités scolaires: culturelles et sportives
- les échanges scolaires; les jumelages.

LES VOYAGES

- les voyages touristiques et les échanges
- les vacances en famille et avec les copains
- les transports.

L'ENVIRONNEMENT

- les paysages; la nature
- la pollution marine; la défense de la planète.

PRATIQUES CULTURELLES

- la vie quotidienne,
- le mode de vie
- les goûts et les préférences
- la mode, la musique etc.

LES RELATIONS INTERPERSONNELLES

- mes amis
- l'amour, la jalousie, la haine
- la surprise, l'indifférences
- les relations conflictuelles
- la force, la faiblesse,
- l'exploit et l'aventure.

CULTURE ET CIVILISATION

- la mode, la publicité
- littérature ; la musique ; la peinture; les vedettes
- les échanges culturels : les jumelages.

LES MOYENS DE COMMUNICATION

- les médias
- la presse
- la télévision
- le téléphone.

Leksiku

Programi ka karakter tematik. Në bazë të temës, përzgjidhet dhe integrohet në të përmbajtja leksikore e domosdoshme, aktet gjuhësore, si dhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e kuptimit të teksteve të larmishme, si edhe të shprehurit me shkrim për tema të larmishme të njohura. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për të përballuar me sukses kuptimin e dokumenteve në gjuhën frënge dhe për t'u shprehur lirshëm e saktë me shkrim.

Aktet dhe funksionet komunikative

Propozohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, që do të shërbejnë si mjete orientuese për nxënësit dhe hartuesit e tezës së provimit:

- Demander et donner des explications, des informations.
- Donner et demander un avis, une opinion
p.ex. je pense que, je crois que, il me semble que?
- Exprimer son accord ou son désaccord
p.ex. je vous approuve sans réserve, je ne partage pas votre avis
- Raconter un évènement, exprimer la durée d'une action
p.ex. Depuis ..., ça fait... il y a ... etc.

- Décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement
- Raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements au passé
p.sh d'habitude ..., chaque matin + imparfait d'abord ... , après... , à la fin ... et.
- Demander et donner des conseils ou des ordres
p.ex. donne- lui son livre! Il ne fallait pas faire cela! Il faut que tu finisses vite!
- Exprimer la cause et la conséquence
- Etant donné que+ indicatif, à la suite de + nom.....,à tel point que, si bien que + idicatif.....
- Exprimer l'opposition, la concession
- exprimer le but (pour + inf., pour que + subjonctif)
- Comparer, exprimer la ressemblance et la différence
p.sh. c'est pareil, c'est tout à fait différent, ça change et.
- Exprimer la condition et l'hypothèse
- Justifier une opinion ou une action
- Rapporter les paroles de quelqu'un.

Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore me shkrim, sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore si më poshtë:

- Les modes et les temps verbaux
- L'indicatif
- Le présent
- Le plus-qu-parfait / l'imparfait/ le passé composé
- Le futur / le futur antérieur
- Les verbes irréguliers
- Les verbes pronominaux
- Le participe et ses accords
- La concordance des temps de l'indicatif
- Le conditionnel présent et passé
- Le subjonctif présent
- Indicatif ou subjonctif
- Le passif et l'actif

- L'infinitif présent et passé
- Le gérondif / le participe passé
- L'impératif
- L'expression de la cause et de la conséquence
- L'expression du but
- L'expression de l'opposition et de la concession.

Les articulateurs

- Les articulateurs logiques
- Les articulateurs temporels.

Les pronoms

- Le complément d'objet direct
- Le complément d'objet indirect
- La place des pronoms: ex. Je le lui donnerai
- les pronoms: y et en
- Les pronoms relatifs simples et composés
- Les pronoms indéfinis
- Les pronoms et les adjectifs possessifs
- Les pronoms et les adjectifs démonstratifs
- La place, le nombre et le genre des adjectifs qualificatifs
- La nominalisation
- Les prépositions
- Les articles partitifs, définis, indéfinis
- Le discours direct / indirekt.